Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
278/20
Datë/Datum 22.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.278/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Blerim DINA – Kryetar penalist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "KOSTO ONE" SH.P.K- Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Eko Term" SH.P.K. – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "EKOREGJIONI" SH.A-Prizren", me nr. të prokurimit: KRMP-19-9690-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KRM "Ekoregjioni" SH.A.-Prizren, më datën: 21.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit: "KOSTO ONE" SH.P.K - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "EKOREGJIONI" SH.A.-Prizren, me nr. të prokurimit: KRMP-19-9690-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KRM "Ekoregjioni" SH.A.-Prizren.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "EKOREGJIONI" SH.A.-Prizren, me nr. të prokurimit: KRMP-19-9690-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KRM "Ekoregjioni" SH.A.-Prizren.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që kon formë dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: "KOSTO ONE" SH.P.K - Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që kon formë nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: "KOSTO ONE" SH.P.K- Suharekë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 08.05.2020 me nr. 278/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Eko Term"SH.P.K. – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "EKOREGJIONI" SH.A-Prizren" me nr. të prokurimit: KRMP-19-9690-2-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KRM "Ekoregjioni" SH.A-Prizren duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.05.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e datës: 12.05.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6, 7 dhe 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE i cilin nuk është i përgjegjshëm sepse në certifikatën e biznesit nuk e ka përshkrim të aktivitetit që lidhet me patundshmëri dhe kjo është në kundërshtim me kërkesën e FDT, OE fitues në përshkrimin e aktiviteteve të veprimtarisë së kompanisë, ka suvatimin dhe punët ndërtimore e jo patundshmëritë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në certifikatën e regjistrimit të biznesit të OE fitues, aktiviteti kryesor i biznesit është "Punime Suvatimi" edhe në aktivitetin sekondar dhe aktivitetet e tjera, nuk ka përshkrim me aktivitete për pasuri të paluajtshme, respektivisht patundshmërive. Meqenëse kërkesa në FDT ka të bëjë me regjistrimin si OE në

regjistrin profesional me dëshmi për informata për biznesin, atëherë OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon informata për aktivitetet që ushtrohen në këtë veprimtari që lidhet me aktivitetin e prokurimit të AK-së. Prandaj ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar

Mendimi i ekspertit profesional:
Autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit te ofertave, nuk ka respektuar në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit sidomos gjatë krahasimit te ofertave.
Është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i cili sipas certifikatës së regjistrimit të biznesit nuk ka asnjë aktivitet të veprimtarisë së biznesit që merret me lëmin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa OE ankues sipas certifikatës së regjistrimit të biznesit, aktivitet kryesor të biznesit ka patundshmëritë dhe menaxhimin e tyre.

Nga kjo rezulton se AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 7 të LPP-së për barazi në trajtim dhe jo diskriminim dhe nenit 59 të LPP-së që thotë se AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Si përfundim të këtij raporti, mbi bazën e të dhënave të konstatuara më lartë, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë Rivlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "Ekoregjioni" SH.A-Prizren" me nr. KRMP-19-9690-2-3-6 në bazë të dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 12.05.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit profesional.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit profesional.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.05.2020, pa praninë e palëve kon formë nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "KOSTO ONE" SH.P.K – Suharekë se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6, 7 dhe 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE i cilin nuk është i përgjegjshëm sepse në certifikatën e biznesit nuk e ka përshkrim të aktivitetit që lidhet me patundshmëri dhe kjo është në kundërshtim me kërkesën e FDT dhe OE fitues në përshkrimin e aktiviteteve të veprimtarisë së kompanisë, ka suvatimin dhe punët ndërtimore e jo patundshmëritë.
Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka kërkuar tek "Përshtatshmëria profesionale: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarjeve në vendin e juaj të themelimit, Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal - Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 - Certifikata e numrit fiskal-kopje. Kurse, tek pika e "Kapacitetit ekonomik dhe financiar" është kërkuar "Dëshmia e kërkuar dokumentare": Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Menaxheri i projektit duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e pronave të paluajtshme, vlerësues i shkallës së PARË-A dhe të ketë përvojë min. 4 vite në vlerësim. 2. Stafi i angazhuar për këtë projekt a. Ekonomist i diplomuar b. Jurist i diplomuar c. Inxhinier i komunikacionit d. Inxhinier i diplomuar i bujqësisë e. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë. 1. Menaxheri duhet të jetë me vendim, të ketë licencën valide për vlerësimin e pasurisë, kontratën e punës ose kontratën për bashkëpunim për këtë projekt. 2. Stafi i angazhuar duhet të kenë diplomat, CV dhe kontratën e punës ose kontratën për bashkëpunim për këtë projekt. Andaj, Paneli Shqyrtues duke marrë për bazë kërkesat e cekura si më lartë konsideron se në asnjërën prej pikave nuk është kërkuar që kodi apo përshkrimi i aktivitetit biznesor të jetë i natyrës së vlerësimit të patundshmërive. Pra, kërkesat e lartcekura kanë të bëjnë me punëtorët e kualifikuar të lëmisë përkatëse, sikurse për menaxherin e projektit duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e pronave të paluajtshme, pastaj të ketë licencën valide për vlerësimin e pasurisë, etj.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të kërkesave të autoritetit kontraktues vjen në përfundim se AK ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit, njëherit duke marrë për bazë edhe nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se çështja kodeve apo përshkrimin e aktiviteteve të veprimtarisë së kompanisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit është çështje teknike pranë ARBK-së, bizneset në Republikën e

Kosovës mund të ushtrojnë çdo veprimtari të ligjshme, pra nuk mund të kufizohen vetëm në kodet që i posedojnë në certifikatë përderisa tenderët apo ofertat e operatorëve ekonomik janë konform kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KRM"Ekoregjioni" SH.A - Prizren

1x1 OE- "KOSTO ONE" SH.P.K- Suharekë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.